

Njoftim për Media - Lista e institucioneve publike

Tiranë, më 30 Shtator 2018: INSTAT, ofron për përdoruesin listën e institucioneve publike që janë pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme si dhe korporatat Financiare dhe Jo-financiare që janë në pronësi të entiteteve publike për vitin 2017.

[Lista e institucioneve publike, pjesë e sektorit publik](#)

Njësitë shpenzuese buxhetore të Sektorit publik përbëhen nga Nën-sektori i Qeverisë Qëndrore (S.1311) me 932 njësi shpenzuese buxhetore, Nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 191 njësi shpenzuese buxhetore dhe Nën-sektori Fondet e Sigurimeve (S.1314) me 2 njësi shpenzuese. Ndryshimi i numrit të njësive shpenzuese buxhetore vjen si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore të Qeverisjes Qëndrore, riklasifikimeve, si dhe njësive të reja apo të mbyllura.

Tab. 1 Sektori Publik në Shqipëri

Klasifikimi sipas Nën-sektorëve		Viti 2017
Qeveria Qëndrore	S.1311	998
	Buxhetore	932
	Extra-Buxhetore	66
Qeveria Federale¹	S.1312	-
Qeveria Lokale	S.1313	286
	Buxhetore	191
	Extra-Buxhetore	95
Fondet e Sigurimeve	S.1314	2
Korporatat Publike Jo-financiare	S.11001	16
Korporatat Publike Financiare	S.12701	1
Banka Qëndrore	S.121	1
Totali i Njësive Shpenzuese		1,304

Njësitë extra-buxhetore të Sektorit publik përbëhen nga Nën-sektori i Qeverisë Qëndrore (S.1311) me 66 njësi shpenzuese dhe Nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 95 njësi shpenzuese.

¹ Numri i njësive buxhetore përfshin njësitë shpenzuese të raportuara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, në Ministrinë e Financave, gjatë vitit 2017.

¹ S.1312 - Qeveria Federale, ky nën-sektor nuk aplikohet në Shqipëri

2017

Ndryshimi i numrit të njësive shpenzuese extra-buxhetore vjen si rrjedhojë e riklasifikimeve, njësive të reja të krijuara apo të mbyllura.

Përveç institucioneve buxhetore dhe extra-buxhetore, sektori publik, përfshin edhe nën-sektorin e Korporatave Publike Jo-financiare (S.11) me 16 njësi, nën-sektorin e Korporatave Publike Financiare (S.12) me 1 njësi dhe nën-sektorin e Bankës Qëndrore (S.121) me 1 njësi. Krahasuar me vitin 2016, Nën-sektori i Korporatave Publike Financiare (S.12) është pakësuar me dy njësi, nga të cilat njëra është privatizuar (INSIG) dhe një njësi është mbyllur (Bursa e Tiranës).